



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT

Raport për rezultatet e konsultimit publik

1. Titulli i projekt aktit

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.29/2024 “Për burimet ujore””.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Ky projektligj synon të ndryshojë ato nene të ligjit nr. 29/2024 “Për burimet ujore”, i ndryshuar, të cilat janë të lidhura me varësinë institucionale të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, nga Kryeministria që është aktualisht, në varësi të Ministrisë së Mjedisit.

Ky ndryshim vjen në vijim të gjetjeve të dala nga Raporti i SIGMA-s i kryer në vitin 2025, lidhur me “Forcimin e qendrës së qeverisjes në Shqipëri”.

Hartimi i këtij projektligji u realizua nga struktura përgjegjëse për konsultimin e publikut në vendimmarrjen mjedisore, në Ministrinë e Mjedisit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Programimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, si dhe drejtoritë teknike në fushën e mjedisit.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.29/2024 “Për burimet ujore”” iu nënshtrua procesit të konsultimit publik përmes publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJKP), në periudhën nga data 9.3.2026 deri më 6.4.2026.

Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 210 shikime, por nuk janë regjistruar komente në RENJKP.

3. Metodatat e konsultimit

Listoni të gjitha metodatat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metoda e konsultimit, e përdorur për këtë projektligj, ishte:

1. Publikimi në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJKP)

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit. Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese. Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Nuk rezultoi të ketë patur palë të interesuara (organizata të shoqërisë civile, subjekte private apo individë), të përfshira në procesin e konsultimit publik të projektaktit.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën; Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato; Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Nuk pati komente apo sugjerime lidhur me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.29/2024 “Për burimet ujore””, të publikuar në RENJK.

Çështja adresuar	e	Komenti (grumbulloni dhe	Palët e interesuara (renditni të	Vendimi (I pranuar/I pranuar	Justifikimi
------------------	---	--------------------------	----------------------------------	------------------------------	-------------

(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	pjesërisht/I refuzuar)	
--	---	--	------------------------	--